

Bardhyl Demiraj

## Aktet e “Kuvendit të Arbënит” dhe rëndësia e tyre në studimet albanologjike

Shfrytëzoj rastin të përmend që në fillim të ligjëratës sime ribotimin e shumëpritur të akteve të “Kuvendit të Arbënит” nën përkujdesin e Mons. Zef Gashit, arkipeshkv i Tivarit<sup>1</sup>, të cilin patëm nderin ta dëgjojmë para do çastesh me fjalën e tij përshëndetëse në tubimin tonë. Rrethet letrare dhe ato shkencore albanologjike mund të përcjellin tash, të përbledhur në një vëllim të vetëm, tekstin burimor të akteve të kuvendit, të shkruar latinisht dhe të përkthyer shqip, pas gjase, nga Mons. Vinçenc Zmajeviq<sup>2</sup>, ripërkthimin të tyre shqip nga At Engjell Ra-doja, si edhe një version të përshtatur në shqipen e sotme letrare nga zoti Anton Berisha, i cili na nderon gjithashtu në këtë tubim me një ligjëratë të veçantë.

Ky botim i ri plotëson një vend bosh në bibliotekat tona, i përfthuar ky qoftë prej largimit të natyrshëm në kohë ndaj botimit të fundit, para plot 131 vjetësh, qoftë prej mungesës – do të thoja të panatyrrshme - të një edicioni kritik të tekstit, që mund dhe duhej të ish përgatitur ndërkokë,

---

<sup>1</sup> Mons. Z. Gashi (botues): *Kuvendi i Arbënitet 1703*, Prishtinë 2003 (= KA<sup>3</sup>)

<sup>2</sup> Shih f. 82, shën. 2.

pas dy studimeve serioze të vetë tekstit<sup>1</sup>. Të tria versionet e këtij teksti ndikojnë padyshim në zgjerimin rrethit të lexuesve dhe hapin hulli të reja leximi në mjedisin e sotëm kulturor-letrar dhe albanologjik. Ai mundëson njëherësh si njohjen e vendimeve të Kuvendit ashtu edhe recepcionin letrar-artistik të vetë tekstit, që bën pjesë padyshim në fondin e vyer të letërsisë shqipe në fazën e parë të zhvillimit të saj.

Gjithsesi tekstit nuk i kanë munguar ndonjëherë lexuesit. Ai ka përjetuar deri sot një sërë leximesh, që kanë bashkëvepruar dhe zëvendësuar njëri-tjetrin. Ndër më të sukseshmit dallojmë leximet e tij:

- si tekst normativ-juridik me orientim doktrinar dhe fetar,
- si dokument gjuhësor, që përcjell të fiksuar shkallën e zhvillimit të gjuhës dhe të shkrimit shqip në fillimet e shek. të 18-të, dhe

---

<sup>1</sup> At P. V. Malaj: "Kuvendi i Arbënit", *Concilio Nationale Albanese del 1703. Inquadramento storico, testo albanese e glossario*. Tesa di laurea, Università degli studi di Roma, Facolta di lettere e filosofia, Corso di laurea in lettere, anno accad.1971-2, Matr. KO 6094 [dorëshkrim doktoranture – cituar sipas R. Ismajlit: *Gjuha shqipe e Kuvendit të Arbënit (1706)*, Prishtinë 1985]. Nga ky disertacion është botuar ndërkohë vetëm pjesa e parë; P. V. Malaj: *Kuvendi i Arbënit 1703*, Prishtinë 1998; Monografia e R. Ismajlit ka fituar ndërkohë statusin e një punimi model në filologjinë e sotme shqipe.

- si monument historik, që pasqyron me besnikëri njërën ndër ngjarjet më të rëndësishme në historinë e kulturës shqiptare në këtë periudhë.

Të tria këto lexime i kam bërë objekt të kumtesës sime, duke u përqëndruar kryesishët në çështje që lidhen:

- me ndikimin e tekstit të formimin dhe kultivimin e kulturës gjuhësore në mjedisin shqiptar të kësaj periudhe,
- me vetë tekstin dhe vandin e tij në qerthullin e teksteve të vjetra shqipe,
- si edhe me paraqitjen e disa dëshmive gjuhësore në tekstu, të cilat pasqyrojnë me besnikëri proceset e zhvillimit të etnosit shqiptar në këtë periudhë.

Leximi i akteve të kuvendit si tekst normativ është sigurisht më i hershmi dhe ka vijuar si i tillë për më se dy shekuj. Shumë domethënës për këtë është fakti, që aktet e "Kuvendit të Arbënit", pos ribotimit të fundit (2003), përjetuan në rrjedhë të kohës një sërë botimesh: teksti original latinisht u botua të paktën tri herë (1706, 1803, 1868); përkthimi i parë shqip dy herë (1706, 1868), për të vijuar katër vjet më pas, në vitin 1872, me përkthimin e dytë, pikërisht një vit pas mbajtjes së Kuvendit të Dytë të Arbënit (qershori 1871)<sup>1</sup>.

---

<sup>1</sup> Shih për këtë më hollësisht Z.Mirdita: Krishtenizimi ndër shqiptarë, Prizren-Zagreb 1998, f. 191; khs.edhe Concilium Albanum Secundum Provinciale sive Nationale habitum anno Pio IX. Pontifice Maximo, Romae 1876.

Rrethi kryesor i lexuesve të tekstit në këtë periudhë do kërkuar pa dyshim në radhët e klerit katolik shqiptar dhe të misionarëve të huaj që vepronin atë kohë në trojet shqiptare. E kjo përkon me vetë qëllimin e mbajtjes së kuvendit, me vendimet që përcolli dhe miratoi ai, si edhe me njohjen dhe zbatimin e tyre në të gjitha famullitë dhe misionet katolike që vepronin në Shqipëri në atë periudhë<sup>1</sup>.

Edhe pse nuk i ndeshim në tekst me një dekret të veçantë, karakter vendimor fitojnë në një mënyrë a një tjetër kërkesat e Kuvendit për njohjen dhe përvetësimin me shkrim të gjuhës shqipe (*krahas latinishtes*), si edhe ato për përdorimin e saj në shërbesat fetare dhe në aktivitetet e tjera shpirtërore të klerit katolik shqiptar. Këto kërkesa i ndeshim të shpërndara në krerë të ndryshëm të tekstit, ku bëhen edhe diferencime të qarta brenda rrethit të lexuesve të tij. Kështu p.sh.:

Famullitarëve u kërkohet:

“... të kënë shkruem ndë kartë gjith këto ligja e këtë Sinodi, e ato të lexonjënë shpesh, me

---

<sup>1</sup> Khs. nga raporti i vizitës apostolike të V. Zmajeviqit në Shqipëri: “... Hâ rimediato uniuersalm.te quanto hâ potuto, e saputo il Visitatore colla celebrat.ne del Sinode, mà perche pochi intendono il Latino, l'hâ tradotto anche in Albanese per istrutt.ne dell'ignoranti; doppo la douuta corrett.ne è di necessità stamparlo, e mandare esemplari per tutte le Chiese d'Albania, e Servia, incaricando alli Vescoui la puntuale esecut.ne dellli Decreti Sinodali. (Relatione: Rimedij universali per l'Albania, e Seruia; shih P.Bartl: Quellen, f. 142)

Aktet e „Kuvendit të Arbënët“ dhe rëndësia e tyre

mend të i kujtonjënë e me vepëra të i mbaronjënë.”<sup>1</sup>

Ata duhet të mësojnë jo vetëm vetë, por dhe popullin:

“Të mpsojnë prā famijat e popullin, me zāni  
të çelë ndë kishë, ndo kudo të thohet mesha.  
Ani postafat te dashunit e Kuvendit Shind të  
Propagandësë, ka me çuem n’ Tarbëni  
doktrinat e Bellarminit shtampuem shqip<sup>2</sup>,  
me të cijat mund prodhonjënë veti e popullit.

„<sup>3</sup>

Fretërve misionarë, të cilët në shumicën e rasteve ishin të  
huaj, u kërkohet që:

“Para se të hīnjënë Misionarët me rëfyem, të  
jenë saminuem prej P[atér] Prefetit, ndo prej  
si, qi urdhënon Prefeti, a dīnë mir giuhën e  
shqipëtarëvet; kinëse të jenë të zot me sheti-

---

<sup>1</sup> Versioni original: “Giξξe Parochi te keene fckruem nde carte  
giξξ ketò lighia e ketii Sinnodi, e atò te lezognene scpefc; me  
mend te i cuitognene, e me vepera te i mbarognene.” (KA<sup>1</sup>: *Të  
paroket*, f. 96)

<sup>2</sup> Pas gjithë gjasash bëhet fjalë këtu për botimin e tretë të  
përkthimit të Pjetër Budit: Dottrina Christiana composta per  
ordine della fel.me. di Papa Clemente VIII. Dal R. P. Roberto  
Bellarmi Sacerdote della Compagnia di GIESU, Romæ 1664.

<sup>3</sup> Versioni origjinal: “Te mpfoine pràa famijat , e Popullin me  
eaani te celle nde kifce , ndò cudò te ξξohet meschia : Ani  
postafat Tedasciunit e Cuvendit Scind te Propagandef, ka me  
civem n’Tarbeni Doctrinat e Bellarminit shtampuem schipp ,  
me tezijat mund proξognene , veti , e Populit.” (KA<sup>1</sup> *Së  
mpsuemi së fësë*, f.27)

tunë ndëpër arë e bashtinë të Tinëzot tue rëfyem e tue predikuem.”<sup>1</sup>

Nxënësit e shkollave fetare të Kurbinit dhe të Lezhës duhet që të fitojnë njohuri të plota në gjuhën latine dhe shqipe. Për këtë kuvendi vendos:

“Ndë të mpsuemi të këtë mieshtri me ligjë me mbaitunë ketë mendyrë. Mbi se të mpsonjënë shkullarëvet me lexuem, t’investigohen ende me shkruem, përsë të dy këto kafsha janë themeli e kamba t’esapit i parokut, ku janë ndërengjënë ato të mpsuema.” ... “Mbas kësosh së mpsuemash, të mpsonjënë të rïvet gramatikën e me folë latin. Të i disqaronjënë

---

<sup>1</sup> Versioni original: “Para se te hiignene Missionaret me refyem , te jene faminuem prej P. Prefettit , ndo prej fsi , chi urçeneon Prefetti , à diine mir giuhen e Schippetarevet : Kinefe te jene te eot me scitetune ndeper are , e basctine te Tineot tue refyem , e tue predicuem.” (KA1: IV, Te Patrevet Missionarevet, f. 105). Meqë ky shembull do të rimerret edhe një herë më poshtë po japid për krasim edhe gjegjësin e vet në tekstin burimor latinisht dhe atë të përkthimit të dytë prej At E. Radojës; khs. “Priusquam verò exponantur officio audiendi confessiones à Patre Præfector, vel ab alio, ad hoc specialiter Deputato, examinentur circa peritiam Albanæ linguæ, ut latissimæ messis, meritique campum tutissimo cursu , & velue inoffenso percurrant pede.” (lat.-KA1: De patribus Missionariis, f. 88-9); “Por prap , para se t’ hîn me rfye, Prefeti, o cusc t’jët shenjue n’ kam t’ ktii, t’i sprovoin, a dîn mîr shqypen; abolla t’ njifen, a jan t’ zot me shetit neper katune e neper mahalla tui rfye paa gabue e pâ i marr n’ qaf shpirnat.” (Radoja, KA3: Permî freten misionâr, f. 353)

shpesh katekizmin e të i banjënë me lexuem këto ligja të provincës.”<sup>1</sup>

Mjaftojnë këta shembuj për të dëshmuar, se teksti i “Kuvendit”, me karakterin e tij normativ, synoi të nxisë jo vetëm formimin gjuhësor të lexuesve të tij, por edhe përdorimin e shqipes me funksione të reja sociale. Nuk mungojnë as raste, kur teksti ka nxitur që në fillim lexues të tij, për t'u marrë konkretisht edhe me njohjen dhe studimin shkencor të shqipes. Shumë domethënës për këtë është fakti që dhjetë vjet më vonë do të shpërndahet në Shqipëri gramatika e parë (e botuar) e gjuhës shqipe, që hartozi pikërisht redaktori i tekstit shqip të akteve të Kuvendit, At Francesco Maria da Lecce (1716). Edhe ky tekstu gramatikor ushtron pak a shumë të njëjtin funksion ndaj lexuesit. Në parathënien e gramatikes Da Lecce shkruan se libri i tij nuk do t'u vlejë vetëm misionarëve italianë që të mësojnë gjuhën shqipe, por edhe popullit shqiptar, i cili:

“... duke mos pasur njohuri shkrimore në gjuhën e tij, e pret me padurim këtë vepër,

---

<sup>1</sup> Versioni original: “Nde Te mpfuem i te keete Miestri me lighie me mbaitune kete mendyre. Mbi se te mpfognene scikułarevet me lezuem, t'invesctognene. endë me fckruem, persë te dγγ ketò cafschia jane ξξemelei, e Camba t' effapit i Parokut, cù Jane nderecchiune atò te mpfuema.” ... “Mbas keffo fe mpfuemaſc, te mpfognene te riivet Gramatiken, e me folle latin. Te i dischiarognene scpeſc Katekiemin, e te i bagnene me lezuem ketò ligjia te Provintiese ...” (KA1: Të shkollesë Kurbinët e të Leshisë, f. 107-8)

për të parë në të, si në një kristal shumë të qartë, imazhin vet.”<sup>1</sup>

Parë nga ky aspekt, teksti i “Kuvendit” arriti optimumin e kërkesave si ndaj lexuesit, ashtu edhe ndaj kohës, për të cilën u hartua. Në historinë e albanologjisë ai mund dhe duhet të vlerësohet edhe si finalizim i dëshirës së gjith-hershme të klerit shqiptar për ruajtjen dhe përkujdesin e gjuhës dhe lëvrimin e shkrimit shqip. Këtë dëshirë dhe synim e ndeshim thuajse në të gjitha tekstet e hershme të traditës letrare shqipe, duke filluar që nga teksti i parë i plotë shqip i Gjon Buzukut:

“U Doni Gjoni .... tue kujtuom shumë herë se gluha jonë nukë kish gjā të ndigluom n’së Shkruomit Shenjtë, n’së dashunit së botësë sanë, desha me u fëdigunë, për sā mujta me ditunë, me zdritudhë pak mendetë e atyne qì tē ndiglonjënë ...”<sup>2</sup>

Të njëjtën dëshirë përsërit thuajssë një shekull më vonë Frang Bardhi:

---

<sup>1</sup> F. Maria da Lecce: *Osservazioni grammaticali Nella Lingua Albanese*, Roma 1716, f. a/4: „E quei Popoli Albanesi dispersi per varie Provincie e Regni, non avendo la notitia scritturale del proprio Idioma, aspettano con impatienza la presente Opera, per osservare, come in chiarissimo Cristallo, la propria imagine.”

<sup>2</sup> Versioni original: “γ Donih ḥoni biri hi bdech Bueuchut. Tue γ chuituō sume herre: seh gluha ioneħ nuche chis: ḥaa teh en digluom: en seh scruomit segħte. En seh dasfunit seh botesse faneħ deffa meyfediguneh per saa muitah meh dituneh. Meh eddritune pach mendete e atuneh hi teh endiglogninh.” (Meshari 1555: *Pasthēnia*)

“Tue pasunë ditë e përditë .... kujtuem me qish copë librë keshë me ndimuem mbë një anë giuhënë tanë që po bdaretë e po bastardhohetë sâ mā parë të ve e mā fort me ndimuem gjithë atyne që janë nd' urdhënitetë Tinëzot ...”<sup>1</sup>

Vetë teksti, gjuha dhe shkrimi tij, dëshmojnë një bashkëlidhje të natyrshme me tekstet e mëhershme të letërsisë së vjetër shqipe të Veriut. Përkthyesi, i cili është njohës i mirë i shqipes, por jo folës burimor i saj<sup>2</sup>, është më se i përditësuar me këtë traditë dhe vijon po atë, duke përdorur thuajse të njëjtën grafi dhe ortografi. I dukshëm është ndikimi i veprës madhore të Pjetër Bogdanit “Çeta e profetëve” (1885)<sup>3</sup>, i cili synon krijimin e një koineje

---

1 Versioni original: „Tue paßtune dite , e perdite (te daſcunitee mij mbaffi hina nde College) cuituem me ghisc zoppe Libre cheſce me ndimuem mbe gnaane ghiuhene tane , ghi po bdarete , e po baſtarçohete faa maa parete vë; e maa fort me ndimuem giçxe atyne ghi iane ndurçenite tine εοτ , e te Scintesse Kifce Cattoliche , es dijne ghiuhene Latine ...”(Dictionarum latino-epiroticum, Romae 1635, f. 3)

2 Në diskutimet e derisotme mbi autorësinë e botimit të parë të tekstit shqip është përjashtuar ndoshta pa forcë argumenti vetë organizatori i “Kuvendit” dhe hartuesi tekstit latinisht të akteve, Mons. Vinçenc Zmajeviqi, i cili në shkrimet e veta pohon qartë dhë në mënyrë të përsëritur, se është ai vetë që tekstin latinisht “...l'hà tradotto anche in Albanese ...” (shih f. 74, shën. 2). Mendime të ndryshme mbështesin Malaj (vep. cit., f. 97vv.) dhe Ismajli (vep. cit., f. 46vv.)

3 P. Bogdani: *Cuneus Prophetarum de Christo Salvatore mundit ...*, I; *De Vita Iesu Christi Salvatoris Mundi ...II*, Patavii 1685 [Botime të tjera: 1691, 1702 – me tituj të ndryshuar]

letrare gjithgege<sup>1</sup>. Është kjo një traditë e shkrimtit shqip që – për fat të keq – vijoi deri aty nga gjysma e dytë e shekullit të 18-të<sup>2</sup>.

Ripërkhimi shqip i të njëjtë tekstu (latin) në një largësi kohore për më se dy shekuj është një rast sa unikal në letërsinë e vjetër shqipe, aq edhe ideal për studimin e zhvillimit historik të shqipes në këtë periudhë. Meqë s'mund të abuzoj me durimin e shumicës së auditorit, duke shtjelluar këtu se si dhe në ç'rrafsh gjuhësor ka ndryshuar sistemi i shqipes përgjatë kësaj periudhe, po ndalem shkurt në disa veçori të dy përkthimeve.

Dallimet midis dy përkthimeve janë të dukshme dhe më se të pritshme. Ato kanë të bëjnë sigurisht edhe me ndryshimet e përfutura ndërkokë në gjuhë, por lidhen më fort me natyrën e përkthimit si akt krijues, me shkallën e njohjes së gjuhës si edhe me synimet që i ka vënë vetes secili përkthyes. Përkthyesi i dytë, At Egjell Radoja është folës burimor i shqipes dhe ka një përgatitje filologjike klasike. Njeh gjithashtu shumë mirë visarini e letërsisë shqipe të Veriut dhe zgjidh me sukses një numër çështjesh të grafisë dhe të ortografisë së shkrimtit shqip<sup>3</sup>. Por synimi i tij është të zgjerojë rrethin e lexuesve, ta çoje tekstin edhe te lexuesi i thjeshtë, prandaj shkruan në të folmen popullore të qytetit të Shkodrës. Është kjo një nga

---

<sup>1</sup> Shih gjerësisht për këtë Ismajli: *vep. cit.* f. 11vv.

<sup>2</sup> Gj.N.Kazazi (Johannes Nicolovich Casasi): „Doktrina e krështen”, Roma 1743.

<sup>3</sup> Shih më hollësisht Ismajli, *vep. cit.*, f. 37vv.

arsyet që ai sinjalizon që në parathënie të tekstit shmangien nga përkthimi i parë:

“Nuk t’thom se n’ket libr, shkrue mieshtrisht prei Vinçenc Zmajevikut, arçipeshkvit t’ Tivarit, knohen fial t’ rea, t’ mocmë e t’ zgiedhuna. Besa une, si flasim shqypen n’ Shkodr, ashtu me t’paken forc temen jam munue · me shkrue, tui çalltis, nderi ku kam muit, m’u shporr fialvet t’ ghiuhvet t’ huejavit, e tui bā gairet edhe ci fialt, ci knohen ktu, t’ jen marrun vesht prei Shqyptarit soçm.”<sup>1</sup>

Përkthimi i parë paraqet gjithsesi vështirësi leximi, andaj është më se i nevojshëm edhe edicioni i tij kritik. E këto vështirësi kanë të bëjnë jo aq me shmangjet e karakterit grafik, se sa me format gramatikore dhe ndërtimet sintaksore brenda frazës, e cila i përshtatet jo rrallë modelit të frazës latine. Këto raste i ndeshim shumë shpesh në tekst, çka e përforcon mendimin se autori nuk është folës burimor i shqipes.

Përkthimi i At Engjëll Radojës siguron, në të kundërtën, rrjedhshmëri leximi. Ndryshe nga teksti i parë ndeshim në të jo rrallë mungesa të tekstit burimor latinisht, gjë që

---

<sup>1</sup> Versioni origjinal: „Nuk t’ξom se n’ket libr, sckrue miescristi prei Vincenz Zmajevikut, arcipesckvit t’ Tivarit, knohen fial t’ rea, t’ moccme e t’ eghieξuna : bessa une, si flassim Scçiypen n’ Skodr, asctù me t’paken forz temen jam munue me shkrue, tui cialtis, nderi ku kam muit, m’u scporr fialvet t’ ghiuhvet t’ huejavit, e tui bâa gairet, eξè ci fialt, ci knohen ktu, t’ jeen marrun vesht prei Scçiyptarit soccm.“ (KA<sup>3</sup>: *Knuesit, mikut, t’ dashtunit*, f. 253)

tumiret me faktin, se nuk i përgjigjen më kohës kur u përgatit botimi i dytë. I tillë është psh. shembulli i cituar më sipër, lidhur me pajisjen e famullive me “doktrinat e Bellarminit shtampuem shqip” (të përkthyer nga Pjetër Budi). Në përkthimin e At E. Radojës e gjithë ajo frazë mungon<sup>1</sup>.

Të dy përkthyesit parapëlqejnë sipas rastit komentin dhe sqarimin e pjesëve të tekstit burimor latinisht, por, ndërsa At E. Radoja zakonisht i veçon këto me shënimë në fund të fakes, përkthyesi i parë i ndërkall ato në tekst. I tillë është psh. një rast në letrën e Zmajeviqit, drejtuar Papë Klementit XI, ku përkthyesi shton në tekstin shqip se “Papa i arbëreshë” në latinisht do të thotë “i bardhë”, khs.:

Teksti burimor:

“.... sub ALBANO PONTIFICE in lucem  
egressa ad aram pristinæ felicitatis cursum  
lætabunda accelerat.” (lat.-KA<sup>1</sup>: *Beatisimo  
patri Clementi XI*, f. 7)

Përkthimi i parë:

---

<sup>1</sup> Khs.: Teksti origjinal latin: “... & altâ voce in eâdem Ecclesiâ Christianam plebem erudiant, iisdemque documentatis informent, Sacræ Congregationis de Propaganda Fide charitatis viscera quâm primûm experturi in libellis Christianæ doctrinæ Bellarmini, Albano idiomate, quibus propriæ, & fidelium necessitatì providere possint.” (KA<sup>1</sup>, f. 18), kundrejt botimit të dytë shqip: “Ato essaye, ci i perménme, Priftnit t’ i msuin, tui i ëxan me eaa sill, ci giçç-i-zili t’i nniuin mir me vësc, e t’i zaan; e kto t’i ëxon n’kisc, cu vien Populi me paa Mesc.” (KA<sup>3</sup> 279)

Aktet e „Kuvendit të Arbënit“ dhe rëndësia e tyre

„... tashti ndënë Papë t’Arbëneshë, që latinisht do me thanë të bardhë, asht dalë mbë dritë e mbë zembrë të mirë, shka thon me rrîm mbë lumëni të shkueme.“ (KA<sup>1</sup>: *Klementit*, f. 7)

Përkthimi i dytë (At E.Radoja):

„... tash ... nen nji Pap Shqyptar po del n’drit e mezi sh’ pret me fitue namin e lumnin e moçme.“ (KA<sup>3</sup>: f. 260)

Rast tjetër<sup>1</sup>:

Teksti burimor:

„Proptera cùm in trinâ ablutione, semel tantum sit proferenda forma Baptismatis, illis verbis: Ego te baptizo in nomine Patris , & Filii , & Spiritus Sancti, ...“ (lat.-KA<sup>1</sup>: “De Baptismo”, f. 27)

Përkthimi i parë:

„Pr’ ata tue dashunë me qitunë ujt tri heresh n’ kryq, forma të flitet veçë nji herë me ato filalë: *Ego te baptizo in Nomine Patris , & Filii , & Spiritus Sancti : ndo me i thanë shqip :Unë të pagëzonj pr’ Emeni t’ Atit e Birit e Shpirtit Shind . .....*“ (KA<sup>1</sup>: *Të pagëzimit*, f. 38)

Përkthimi i dytë (Radoja):

---

<sup>1</sup> Për raste të tjera shtesash apo heqjesh nga teksti burimor shih Malaj f. 177v.

“Pranei tu’u çit uj n’pagzim tri heresh, fialt nuk do t’ thohen veçse një her. Fjalt e pagëzimit jan: “Une po t’pagzoi n’emen t’Atit , t’Birit e t’Scpirtit Scëit.” … ” (KA<sup>3</sup>: *Permî pagzim*, f. 289)

Përzasja e shembujve të mësipërm dëshmon qartë se në të dy tekstet mbizotëron përkthimi i lirë sipas kuptimit (*ad sensum*). Është rasti të risjellim këtu edhe një herë pë diskutim shembullin e cituar më lart lidhur me misionarët e huaj, që duhet të provohen nëse “dînë mir giuhën e shqipëtarëvet”. Togut *giuhën e shqipëtarëve* (emër + emër në rasën gjinore) i përgjigjet në përkthimin e At. E.Radojës vetëm emri i gjuhës: “a dîn mir shqypen”<sup>1</sup>. Në të dy rastet kemi të bëjmë me një përkthim të lirë të togut latin *albanæ linguæ* (mbiemër + emër në rasën gjinore) [= së gjuhës shqipe; khs.: *circa peritiam albanæ linguæ* = rreth njoħjes së gjuhës shqipe]. Është pikërisht kjo shmangie e vogël në përkthim, në dukje krejt e papërfillshme, që i ka shtuar edhe më shumë vlerën tekstit të Kuvendit si monument historik i kulturës shqiptare. Prandaj do të ndalem shkurt në këtë pikë të fundit.

Teksti i përkthimit të parë përcjell një herë të vetme, por gjithsesi për herë të parë në historiografinë e botimeve shqip – që njohim deri më sot – emrin etnik *shqiptar*. Pérndryshe lexojmë gjithkund në tekst shenjuesin etnik “i arbëneshi” në ndërtimë nga më të ndryshmet, si psh.: “populli i arbëneshi, Papa i arbëneshi” etj. Në tekstin e përkthimit të dytë hetojmë një situatë krejt të përbysur. “Populli i arbëneshi” shndërrohet në “populli shqyptar”

---

<sup>1</sup> Shih më hollësisht f. 79, shën. 1

ose jepet me emrin etnik “shqyptar”, “Papa i arbëneshi” lexohet “Papë shqyptari” e kështu me radhë. Shumë rrallë ndeshim në përkthimin e dytë emrin tjetër etnik “arbnor” për “(i) arbënesh”. Por përkthyesi e përdor atë më fort me vlerë stilistike dhe për hir të traditës intelektuale shqiptare, pra me synimin për t’i përcjellë lexuesit shqiptar pjesë nga historia e dikurshme e popullit të tij.

Ndërsa vetë shqiptarët në gjithë hapësirën e tyre jetike në Ballkanin perëndimor e kanë “mënjanuar” nga përdomimi popullor emrin etnik *arbënesh / arbëresh, arbër / arbën* popujt fqinjë dhe të tjerë i dallojnë ata sot e gjithë ditën me këtë emër, khs.: ser. *árbanas*, gr. *alvanós, arvanítis*, turq. *arrnaut*, it. *albanese*, dt. *Albaner* etj.

Me këtë emër etnik dallojnë përkatësinë e tyre edhe folësit e diasporave arbëreshe në Greqi dhe në Italinë Jugore, të cilët janë shpërgulur në ato vise kryesishët në periudhën midis shek. të 13.-15.-të. Po me këtë emër identifikohen edhe folësit e diasporës së Zarës (Zadar pranë Zagrebit/Kroaci), të cilët janë shpërngulur aty në vitet 20 të shek të 18-të pikërisht nga trojet ku vepronate dikur Kuvendi i Arbënit.

Shumë është shkruar, shkruhet dhe do të shkruhet për këtë emër: si është formuar, kur filloi të përdoret dhe pse u përgjithësua “kaq vonë” nga vetë bartësit e tij, që flasin *shqip*?<sup>1</sup> Megjithëse dëshmohet një herë të vetme, vlera e

---

<sup>1</sup> Shih, ndër të tjerë, Sh. Demiraj: *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Prishtinë 1989, f. 213vv. (me literaturë shteruese të studimeve përkatëse).

Bardhyl Demiraj

tekstit shtohet, sepse i përcjell lexuesit shtysat sociale dhe kulturore që ndikuan në përgjithësimin e tij.

### *Deutsche Zusammenfassung*

#### **Die Akten des Albanischen Nationalkonzils und ihre Bedeutung in den albanologischen Studien.**

Mit Blick auf die bisherigen Lesungen des ins Albanische übersetzten Textes (1706, 1872) des Albanischen Nationalkonzils (1703) als: 1) normativ-taxativer Text; 2) sprach- und literaturhistorisches Dokument; und 3) kultur-historisches Denkmal, werden in diesem Vortrag folgende Fragen behandelt:

Zu 1) Die Rolle des Konzils zur Förderung der albanischen Sprache und Schrift, sowie deren weitgehender Gebrauch bei den geistlichen Aktivitäten des albanischen Klerus, des weiteren der in Nordalbanien wirkenden katholischen Missionen.

Zu 2) Die Stellung des Textes in der altalb. Literatur und Anmerkungen zu den beiden Übersetzungen: Der erste Übersetzer (Zmajević ? - 1706) folgt grundsätzlich der bislang mageren albanischen Schriftradtion in der vorwiegend religiösen nordalbanischen Literatur (: Graphie, Orthographie, Wortschatz). Es fällt der Einfluss von Pjetër Bogdani auf, der in seinem Werk „Çeta e Profetëve ...“ (: Petro Bogdano: *Cuneus Prophetarum ...*, 1685<sup>1</sup>, 1691<sup>2</sup>, 1702<sup>3</sup>) den Weg zur Entwicklung einer gemeingegischen Literatursprache bahnte. Der zweite Übersetzer (E. Radoja - 1872) beschränkt sich im Gegenteil auf die Mundart der katholischen Gemeinde der Stadt Shkodra (Scutari), indem er offenbar auf die Erweiterung des Leserkreises zielte.

Mit Bezug auf den lat. Originaltext sind die beiden Übersetzungen meistens frei (*ad sensum*). Manches Abstreichen von Textstücken im Originaltext (bes. bei Radoja) wird in anderen Textstellen durch eigene Kommentare ersetzt, die Radoja in Fußnoten verlegt, während Zmajević diese in den Text einfügt.

Zu 3) Sprachzeugnisse: Dank einer freien Übersetzung wird im ersten alb. Text zum ersten Mal in der bislang zu uns gekommenen albanischen Literatur- und Geschichtsschreibung der Volksname *shqiptar* „Albanischsprecher, derjenige der albanisch spricht“, womit sich die Albaner heute selbst bezeichnen, erwähnt: (Orig.-text) „.... *examinentur circa peritiam albanæ linguæ.*“ ~ (1. Übs.) „.... *a dīn mir giuhën e shqipëtarëvet.*“ ~ (2. Übs.) „.... *a dīn mir shqypen.*“ Über das Entstehen und Durchsetzen dieses Volksnamens unter den Albanern ist und wird inzwischen viel geschrieben. Derjenige, der den Text liest, wird sich selber ein Gesamtbild über die sozialen und kulturellen Triebkräfte verschaffen, die diesen wundersamen Namen hervorgebracht haben.